



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:069775

Datë: 24.05.2021

Numri i dokumentit: 01831352

C.nr.993/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit I.M nga fshati“...” Komuna Kaçanik, të cilin e përfaqëson me autorizim av.Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër të paditurës Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj, në çështjen juridike pagesa e shpërblimit jubilar, në seancën e mbajtur me datë 11.05.2021 mori, kurse me datën 24.05.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit I.M nga fshati “...” Komuna Kaçanik, si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj, që paditësit I.M në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar 100% të një page t’ia paguaj shumën prej 1,111.03€(njëmijë e njëqind e njëmbëdhjetë euro e tre cent), me kamatë ligjore prej 8% nga data 11.05.2021, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 125€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

III REFUZOHET pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës për përfaqësim në një seancë në shumë prej 135 euro si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, ka deklaruar se mbetet edhe më tutje në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe pranë precizimit të saj, duke shtuar se nga provat e administruara, dhe atë lista e pagës është vërtetuar se paditësit ka përvojë të punës 30 vite dhe të njëjtit i takon një

pagë bazë bazuar në nenit 35 par. 8 të Kontratës Kolektive, dhe meqenëse sipas listës së pagës pa e paditësit është 1,111.03 euro mbi bazën e të cilës e kemi precizuar edhe lartësinë e kërkesëpadisë andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që të kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar me kamat ligjore si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i të paditurës gjatë shqyrtimit të çështjes, si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim edhe më tutje pranë përgjigjes në padi duke kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke shtuar se e paditura në pamundësi të mjeteve financiare nuk ka mundur t'i paguaj paditësit shpërblimin jubilar pasi që me Kontratën Kolektive të Arsimit nr. 24 dt.18.04.2017 nënshkruar në mes SBASHK-ut në njërin anë dhe MASHT, për zbatimin e saj është edhe mundësia financiare për realizimin e këtyre të drejtave, andaj në rastin konkret e paditura nuk ka mundur ta zbatoj këtë kontratë pikërisht për shkak të pamundësisë financiare pasi që nuk kemi vij buxhetore për këtë kategori, andaj mbi këtë bazë edhe më tutje e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve si dhe ka kërkuar që e njëjta të refuzohet në tërësi.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve ka bërë administrimin e provave si vijojnë, autorizimi i paditësit dhënë av.Sheremet Ademi dhe av.Leutrim Ademi dt.11.03.2020, kërkesa e përpiluar nga Sindikata e Pavarur e USHAF drejtuar te paditurës në procedurë administrative dt.28.02.2020, vendimi i të paditurës nr. Protokolli "...” dt.02.03.2020, autorizimi i të paditurës dhënë përfaqësuesit Armend Hysa, lista e pagës për muajin Tetor 2020, kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës nr.protokolli "...” dt.25.09.2017.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe nuk është kontestuese fakti se paditësi i ka tridhjetë vite përvojë pune dhe se lartësia e pagës neto është 1,111.03€ në muaj.

Gjykata përmes kontratës së punës e cila është administruar ka vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë së shpërblimit jubilar në shumën neto prej 1,111.03€, është bazuar në listën e pagës për muajin Tetor 2020.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale, është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive, e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjta përfiton nga kjo kontratë për faktin se me rastin e arritjes së përvojës së punës prej 30 vite të tij, kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Sa i përket pagës jubilarë gjykata është bazuar në nenin 35 par.8 pika 8.1 dhe 8.2 të Kontratës Kolektive duke u bazuar në listën e pagës rezulton që paditësi I.M ka përvojë pune 30 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën e që sipas kësaj kontrate për 30 vite të përvojës në punë të punëdhënësi i fundit duhet të i paguaj punë marrësit 100% të vlerës të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit është 1,111.03€, siç vërtetohet përmes listës së pagës i bje që në emër të 100% pagës jubilarë paditësit i takon shuma prej 1,111.03€.

Sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditësit, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha institucionet e arsimit të lartë, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste respektivisht nuk ka vij buxhetore andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata u bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën që paditësit t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 135€ dhe atë për përpilim të padisë shumë prej 104€, për taksën gjyqësore për padi 21€, kurse pjesën tjetër në shumë prej 135 euro për përfaqësim në seancën e datë 11.05.2021, e ka

refuzuar si e pa bazuar pasi që janë krijuar me fajin e të autorizuarit të paditësit meqenëse për gjykatën i njëjti ka mundur me kohë ta precizonte kërkesëpadinë, e gjykata të kishte mundësi të vendoste jashtë seancës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.993/20, me datën 24.05.2021

Gjyqtari
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.